Gjynahet më të mëdha janë: shirku ndaj Allahut, siguria nga të papriturat e Allahut dhe humbja e shpresës në mëshirën e Allahut

Abdullah ibn Mesudit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ ka thënë: "Gjynahet më të mëdha janë: shirku ndaj Allahut, siguria nga kurthet (të papriturat) e Allahut dhe humbja e shpresës në mëshirën e Allahut."
[Senedi i këtij hadithi është sahih (i shëndoshë)] [E shënon Abdurrezzaku]

I Dërguari i Allahut ﷺ ka përmendur në këtë hadith gjynahet që konsiderohen më të mëdhatë, e ato janë: t'i bëhet Allahut ortak (shirk) në zotërimin ose adhurimin e Tij. Me këtë e filloi, sepse është mëkati më i madh. Pastaj këputja e shpresës nga Allahu, sepse ky është mendim i keq për Allahun dhe mosnjohje e mëshirës së Tij të gjerë, si dhe siguria nga afatizimi që ia bën robit, duke i dhënë begati, derisa ai ta dënojë duke qenë i shkujdesur. Ky hadith nuk ka për qëllim t'i kufizojë mëkatet e mëdha në ato që u përmendën, sepse mëkatet e mëdha janë të shumta, por të shpjegohen se cilat janë mëkatet më të mëdha.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/6049